

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 12957/15

Muhamet Kerpaci

kundër Shqipërisë

(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 6 prill 2023, si Komision, i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e përkohshme e Seksionit,*

pasi morën në konsideratë kërkesën e mësipërme paraqitur më 18 prill 2015,

duke marrë në konsideratë deklaratat formale sipas së cilave pranohej një zgjidhje miqësore e çështjes,

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkesës janë paraqitur në tabelën bashkëlidhur.

Qeverisë shqiptare (“Qeveria”) iu komunikuan ankesat e kërkesës në mbështetje të nenit 6§1 dhe nenit 13 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave civile dhe mungesën e zgjidhjes efektive.

Gjykata mori deklaratat për zgjidhjen miqësore të nënshkruara nga palët, sipas të cilave kërkesuesi binte dakord të hiqte dorë nga pretendime të tjera ndaj Shqipërisë në lidhje me faktet që çuan në këtë kërkesë, pas angazhimit të Qeverisë për t’i paguar atij shumën e detajuar në tabelën bashkëlidhur. Kjo shumë do të konvertohet në monedhën e shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e pagesës, dhe do të duhet të shlyhet brenda tre muajve nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës. Në rast se kjo shumë nuk paguhet brenda periudhës tremujore përmendur më sipër, Qeveria merr përsipër të paguajë interesin e thjeshtë ndaj saj, nga përfundimi i periudhës deri në shlyerje, në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonesës plus tre për qind pikë.

Pagesa do të jetë zgjidhja përfundimtare e çështjes.

LIGJI

Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo gjykon se zgjidhja mbështetet në respektin për të drejtat e njeriut sipas parashikimeve në Konventë dhe të protokolleve të saj, dhe nuk gjen arsye për të justifikuar shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës.

Për sa më sipër, është e drejtë që çështja të çregjistrohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë anonime,

Vendos të çregjistrojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve në mbështetje të nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 11 maj 2023.

Viktoriya Maradudina
Zëvendësregjistrare e përkohshme

Ioannis Ktistakis
Kryetar

SHTOJCË

*Kërkesa që paraqet ankesat e bëra në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës
(kohëzgjatje e tepërt e procedurave civile)*

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Ankesa të tjera sipas praktikës gjyqësore të konfirmuar	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së deklaratës së kërkuarit	Shuma e akorduar për dëmin jopasuror për kërkuar (në euro) ¹
12957/15 18.4.2015	Muhamet Kerpaci 1958	Neni 13 – mungesa e zgjidhjes efektive në ligjin e brendshëm	15.12.2022	19.9.2022	1,000

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuarit.